

OBJEKTIVAT FORMUES TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

a. Profili kulturor dhe profesional i studimit në përfundim të programit mësimor

Programi mësimor 'Bachelor në Infermieri - Mami' formon Infermiere mami me formim të përgjithshëm, në përputhje me misionin madhor të FSHP, që është të rrisë standartet e shëndetit komunitar nëpërmjet mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe komunikimit.

Ky program mësimor synon formimin profesional të infermiereve mami që ata të jenë plotësisht kompetentë për të përmbushur nevojat që parashtron profesioni i tyre, në një mjedis dinamik të kujdesit shëndetsor në shërbimin parësor dhe dytësor. Spektri i kompetencave infermiere po vjen duke u zgjeruar vazhdimisht dhe programet që ne ofrojmë synojnë formimin e specialistëve të infermiereve mami për të sotmen e për të ardhmen.

Objektivat e këtij programi përfshijnë:

- Plane bashkëkohore të asistencës infermiere në praktikën infermiere.
- Të menduarit kritik në gjykimet dhe vendim-marrjet profesionale.
- Të mësuarit e bazuar në problem.
- Komunikimin efektiv me të tjerët.
- Kontribuimin në rritjen e kapaciteteve shëndetsore komunitare.

Në përfundim të programit të studimeve studentët do të marrin diplomën: **Bachelor në Infermieri Mami.**

b. Njohuritë dhe kompetencat e studentëve në përfundim të programit mësimor.

Gjatë gjithë periudhës së formimit studentit do t'i duhet të zhvillojë aftësitë e nevojshme për të kontribuar në dhënien e përkuqdesjeve cilësore, me qëllim që të ndikojë në përmirësimin e shëndetit të popullsisë dhe të ushtrojë profesionin në gjirin e një ekipi shumëdisiplinor në sektorët sanitarë e socialë.

Në përfundim të programit mësimor studentët do të jenë të aftë:

- Të ofrojnë shërbim promovues, parandalues, trajtues ndaj shtatzanisë, lindjes dhe amësisë.
- Të komunikojnë dhe të mësojnë çështje që lidhen me punën e mamisë.
- Të vlerësojnë, justifikojnë dhe të zhvillojnë praktikën profesionale duke përdorur qasjen analitike.
- Të bashkëpunojnë me gruan, të afërmit, kolegët dhe profesionistët e tjerë të shërbimit shëndetsor, duke respektuar etninë, fenë, statusin socio – kulturor.
- Të aplikojnë njohuri bashkëkohore duke marrë pjesë në kërkim shkencor dhe në zhvillimin kujdesit infermior në fushën e mamisë.
- Të vazhdojnë të zhvillojnë aftësitë e tyre përmes edukimit në vazhdimësi.

c. Mundësitë për punësim

Në përfundim të këtij programi të ciklit të parë të studimeve, studentët do të kenë njohuri, vizion, aftësi dhe eksperiencë të mjaftueshme për të ofruar një kujdes infermior me cilësi të lartë, bashkëkohor, të bazuar mbi gjykimin kritik të fakteve tek një spektër i gjerë të pacienteve në çdo hallkë të shërbimeve parësore dhe dytësore:

- Reparti i Maternitetit - Terapi Intesive / Spital Rajonal, rrethi apo Spitalet Universitare
- Reparti i Neonatologjisë - Terapi Intesive / Spital Rajonal, rrethi apo Spitalet Universitare
- Konsultorin e gruas / Shërbimi shëndetsor parësor.
- Qëndrat e planifikimit familjar / Shërbimi shëndetsor parësor.